

KËSHILLI I NDERIT PRANË SHOQATAËS SË GAZETARËVE TË MAQEDONISË, SHGM, në seancën e mbajtur më **20.04.2023**, duke vepruar sipas parashtrësës së dorëzuar nga ueb portali **“FAKTOR”** kundër Shërbimit të Verifikimit të Fakteve **“Vistinomer”** të Fondacionit Metamorfozis për një kontrollë të lajmeve të rrejshme , solli këtë

VENDIM

- 1. KONSTATOHET SHKELJE E NENIT 1 TË KODEKSTIT TË GAZETARËVE NGA ANA E PORTALIT “FAKTOR”**
- 2. KONSTATOHET SHKELJE E PARIMEVE ETIKE NGA ANA E “VISTINOMER” DUKE MOS THEKSUAR AUTORËSINË E KONTROLLEVE TË BËRA TË FAKTEVE, NË LIDHJE ME NENET 6 DHE 16 TË KODEKSIT**

ARSYETIM

Deri tek Këshilli i Nderit në SHGM, portali Faktor ka dorëzuar reagim kundër Servisit për Verifikim të Fakteve “Vistinomer”, në të cilin pohon se “Vistinomer” në mënyrë të qëllimshme dhe tendencioze bën recensim të teksteve të tyre, duke jua prishur kështu imazhin, besueshmërinë dhe leximin, dhe këtë po e bënin gazetarë që punojnë në media të konkurrencës, gjë që është në kundërshtim me Kodin Etik.

Shkas konkret për reagimin e Faktor-it ishte verifikimi i faktit për një lajm të publikuar në portalin e tyre me titull “Vjedhje në Aaerodrom, tek Skopjanka” që është dëshmuar të mos jetë plotësisht e vërtetë, dhe kjo ka qenë shkas që pas kontrollit të Vistinomer, informacioni të hiqet nga rrjeti social Fejsbuk ku është shënuar se informacioni është i rrejshëm, ndërsa faktet janë verifikuar nga kontrollues të pavarur”.

Edhe përkundër shpjegimit të detajuar të Faktor-it se përse e kanë publikuar informacionin e lëshuar nga një lexues, ndërsa nuk kanë marrë konfirmim apo demantim nga MPB para se ta publikojnë, **Këshilli i Nderit KONSTATOI se është shkelur neni 1 nga Kodeksi i Gazetarëve , pasi që redaksia e Faktor-it është dashur që ti bëjë kontrollat e nevojshme para se ta publikojë lajmin, pavarësisht se në çfarë mënyre dhe kush jua ka dorëzuar. Vjedhja eventuale për të cilin ka raportuar Faktor, ndërsa lajmin pa asnjë kontroll e kanë kopjuar një numër i madh mediesh, përfshirë edhe televizionet, doemos duhej të kontrollohet në vendngjarje, nëse nuk ka qenë e mundur që të verifikohet në mënyrë institucionale , sidomos duke marrë parasysh se lokacioni është në qendrën e Shkupit.**

Pohimi i portalit Faktor se ky informacion nuk ka shkaktuar dëm, është i papërshtatshëm pasi i njëjti është përcjellë nga më shumë media dhe ka shkaktuar frikë dhe panik tek qytetarët. Servisi për Verifikim e Fakteve Vistinomer ka bërë analizë të kësaj informate dhe ka vërtetuar se bëhet fjalë për lajm të rrejshëm, se nuk ka pasur vjedhje, por veprime hetimore të MPB-së.

Këshilli ka konstatuar se “kontrollin” e ka bërë “ekipi i Vistinomer-it”, gjë që është dalje nga standardet gazetareske pasi që autorësia është e pa-cenueshme dhe e detyrueshme. Pavarësisht që Vistinomer i ka theksuar redaksinë dhe bashkëpunëtorët e jashtëm, Këshilli i Nderit nuk është një organ hetues që të verifikojë se kush qëndron pas tekstit që është lëndë e parashtrësës dhe nuk mund të kontrollojë nëse mbajnë ujë akuzat e Faktor-it se pas teksteve qëndrojnë gazetarëve që punojnë për media të konkurrencës, për çka mund të vendoset një dyshim i bazuar për shkelje të neneve 6 dhe 16 të Kodeksit.

Për çështjet e tjera për të cilat Faktor kërkon mbrojtje nga SHGM, Këshilli i Nderit thekson se kjo mund të jetë lëndë e mbrojtjes gjyqësore, e jo e vetë-rregullimit apo konstatimit të shkeljeve të Kodeksit të Gazetarëve, për çka edhe është kompetent Këshilli i Nderit.

Vendosur në Shkup, më 20.04.2023

KËSHILLI I NDERIT PRANË SHGM-SË
Kryetar i Këshillit
Sashe Dimovski

